UDHËZIM
Nr. 4, datë 19.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 12.2.2015, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 106 dhe 107 të Kodit të Procedurave Administrative, të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 26.9.1994, "Për shtesë mbi pagën bazë për kualifikim të mësuesve dhe shtesë për veprimtari të inspektorëve të arsimit",

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e nenit 2 të udhëzimit nr. 2, datë 12.2.2015 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", ndryshon si vijon:

"Duke filluar nga viti 2014-2015 e në vazhdim, mësuesit që plotësojnë kriteret e pikës 2, kanë të drejtë të aplikojnë për të fituar kategorinë e kualifikimit, nëse kanë kryer të paktën 3 ditë trajnimi në vit, të cilat janë të barasvlershme me 18 orë trajnimi të pasqyruara me 1 kredit".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, IZHA, AKP, ISHA, DAR/ZA, institucionet arsimore dhe agjencitë trajnuese.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla